

NEVOJAT PËR KUALIFIKIMET E SË ARDHMES NË SEKTORIN E ENERGJISË NË SHQIPËRI

Përmbledhje e raportit

Deklaratë për përjashtim nga përgjegjësia

Ky raport u përgatit nga ETF-ja.

Përmbajtja e raportit është përgjegjësi vetëm e ETF-së dhe nuk pasqyron medoemos pikëpamjet e institucioneve të BE-së.

© European Training Foundation, 2022

Riprodhimi lejohet me kushtin që të përmendet burimi.

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	3
1. SEKTORI I ENERGISË NË SHQIPËRI	4
2. MOTORËT E NDRYSHIMIT NË SEKTORIN E ENERGISË	5
3. INOVACIONI NË FUSHËN E ENERGISË	6
4. NDRYSHIMI I KËRKESAVE PËR VENDET E PUNËS DHE KUALIFIKIMET NË SEKTORIN E ENERGISË	8
5. NISMAT E SEKTORIT PËR TË PLOTËSUAR NEVOJAT E NDRYSHUESHME PËR KUALIFIKIME	9

1. Sektori i energjisë në Shqipëri

Me një popullsi prej 2,8 milion banorë dhe PBB prej 15,8 miliardë USD, Shqipëria ka pasur një rritje vjetore mesatare prej 2,4% për 10 vitet e shkuara (Forumi Ekonomik Botëror, 2019). Shërbimet përbëjnë thuhetse 48% të PBB-së, ndjekur nga industria me 30% dhe nga bujqësia me 18%. Industritë kryesore janë hidrocentralet, turizmi, tekstilet, minierat dhe metalurgjia. Ekonomia e vendit është tejet e varur nga tregtia me Italinë, e cila përbën 52% të të gjitha eksporteve. Shqipëria i përket një grupi të vogël vendesh që prodhojnë të paktën 90% të energjisë elektrike nga hidrocentralet. Në vitin 2019, produktet e naftës kontribuan thuhetse me 58% të prodhimit total të energjisë primare, ndjekur nga energjitë e përtëritshme me rreth 36%, nga karburantet e ngurta me 3% dhe nga gazi natyror me 3% për pjesën e mbetur. Në vitin 2019 Shqipëria importoi thuhetse 32% të konsumit të përgjithshëm të energjisë. Pjesën më të madhe të konsumit e zuri transporti me 40% dhe konsumi familjar me 24%. Në dritën e rreziqeve që vijnë nga ndryshimet klimatike, sfidat më të mëdha të sektorit të energjisë janë: diversifikimi i burimeve të energjisë, rritja e efikasitetit dhe e kursimit të energjisë si dhe përmirësimi i menaxhimit të rrjetit të energjisë. Si rezultat i pamjaftueshmërisë në rritje të ujit, pjesa e prodhimit vjetor të energjisë nga hidrocentralet mund të bjerë nga 15% në 20% deri në vitin 2050, por burimet e përtëritshme si dielli dhe era ofrojnë potencial të pashfrytëzuar në vend. Shërbimet përbëjnë pothuajse 44% të punësimit në Shqipëri, ndjekur nga bujqësia me 36% dhe nga prodhimi e ndërtimi me 20%. Kur krahasohen me kontributin përkatës në PBB-në e vendit, këto përqindje tregojnë produktivitet të lartë në industri dhe produktivitet të ulët në bujqësi. Norma e punësimit 67% është më e ulët se mesatarja e BE-së, ndërsa norma e papunësisë qëndroi në nivelin 11,6% gjatë vitit 2019. Sa i takon nivelit të arsimit, 21% e krahut të punës në Shqipëri ka arsim të nivelit të tretë, 35% ka arsim të mesëm dhe 44% ka nivel të ulët arsimor (krahasuar me 17% në BE). Në vitin 2019, grupi më i madh i të punësuarve (36%) në krahun shqiptar të punës përbëhej nga punëtorët e kualifikuar në bujqësi, pylltari dhe peshkim, edhe pse kjo përqindje ka pësuar rënie gjatë pesë viteve të fundit. Në të njëjtën periudhë u rrit përqindja e personave të punësuar në pozicione pune profesionale (12%) dhe në fushën e shërbimeve dhe shitjeve (17%). Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se krahu i punës po arsimohet dhe kualifikohet më shumë, por niveli i kualifikimit mbetet më i ulët krahasuar me atë që haset mesatarisht në BE-28. Tregu i punës në Shqipëri ka një sektor të gjerë informal. Ekonomia informale përbën një të tretën e PBB-së kombëtare. Punësimi në sektorin e energjisë në Shqipëri nuk është intensiv: me përjashtim të transportit (2,3%), çdo nënsektor individual (energji, miniera dhe ujë) përbën më pak se 1% të punësimit total në shkallë vendi. Vendet e punës në secilin prej këtyre nënsektoreve duket se janë më pak të kualifikuara sesa mesatarja në BE-28. Por pjesa e punësimit përfaqësuar nga profesione shumë të kualifikuara është rritur për periudhën midis 2014 dhe 2019, duke u dyfishuar pothuajse në sektorin e energjisë elektrike. Brenda po të njëjtës periudhë, përqindja e vendeve të punës të përfaqësuara nga personat me arsim të lartë u rrit në mënyrë të ndjeshme. Gratë janë të nënpërfaqësuara në sektorin e energjisë. Por, me më shumë se 40% të krahut të punës me moshën mbi 50 vjeç, në të ardhmen do të rritet nevoja për zëvendësimin e punëtorëve, prandaj ka vend për rritjen e punësimit të grave në këtë sektor.

2. Motorët e ndryshimit në sektorin e energjisë

Disponueshmëria e burimeve të energjisë: edhe pse Shqipëria ka përfituar nga burimet e saj masive ujore për të zhvilluar rrjetin e saj të hidrocentraleve, studimet kanë theksuar se do të jetë një nga vendet që do t'i nënshtrohet më shumë stresit hidrik deri në vitin 2040. Prandaj, është e rëndësishme që Shqipëria të shkojë drejt diversifikimit të burimeve alternative të energjisë si era dhe dielli.

Harmonizimi me BE-në: si vend kandidat për t'u anëtarësuar në BE, Shqipëria po transponon legjislacionin e BE-së në legjislacionin e saj të brendshëm. Në mënyrë të veçantë, ky legjislacion lidhet me respektimin e objektivave që synojnë rritjen e përdorimit të burimeve të përtëritshme, përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe uljen e shkarkimeve të CO2.

Investimet e huaja: Shqipëria po inkurajon injektimin e kapitalit të huaj në sektorin e saj të energjisë dhe shoqëritë evropiane të energjisë kanë investuar në vend. Projekte të ndryshme, në zbatim e sipër ose të planifikuara, financohen nga fondet e BE-së ose nga huatë e institucioneve financiare ndërkombëtare si dhe do të nevojiten investime të mëtejshme.

Mjedisi i qëndrueshëm: ndikimi negativ në mjedis i strukturave hidroelektrike po shpie drejt zhvillimit të zgjidhjeve të reja energjetike si prodhimi i lëndëve djegëse nga mbetjet ose nga plastika. Një faktor tjetër është prania e zonave të mbrojtura pyjore, të cilat mbulojnë rreth 22% të territorit dhe pritet të rriten.

Ndryshimet klimatike: pakësimi i sasisë së shirave parashikohet të ushtrojë ndikim të madh në sektorin energjetik në Shqipëri, prodhimi energjetik i së cilës varet për më shumë se 90% nga hidrocentralet.

Politikat kombëtare: politikat shtetërore janë instrumente të rëndësishme për nxitjen e përdorimit të inovacionit. Në Shqipëri, qeveria ofron mekanizma për të nxitur prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e përtëritshme.

Risitë teknologjike: po futen teknologji të reja për përdorimin e drejtpërdrejtë të burimeve të reja të energjisë, si energjia nga dielli. Teknologjitë e reja mund edhe të rritin kontrollin mbi proceset dhe impiantet e prodhimit. Digjitalizimi do të krijojë hapësirë për prodhim, transmetim dhe shpërndarje më efikase.

Rritja ekonomike dhe konsumi i energjisë: rritja ekonomike në vend do të shkaktojë rritje të konsumit të energjisë, duke theksuar problematikat si energjia e përtëritshme dhe kthimi i sektorëve ekonomikë në sektorë të gjelbër. Anketat tregojnë se konsumi i energjisë nga familjet në Shqipëri është rritur me 10% për periudhën 2009- 2016. Duke u bazuar te kjo prirje, në të ardhmen do të nevojitet më shumë energji.

3. Inovacioni në fushën e energjisë

Në sektorin e energjisë, zgjidhjet teknologjike në vend janë kryesisht të importuara nga shoqëritë tregtare evropiane. Duke qenë se vendi nuk ka regjistër patentash në fushën e energjisë, për të mbushur këtë boshllëk u përdor analiza e patentave evropiane. Rezultatet e përgjithshme tregojnë se energjia nga era ka qenë sektori me veprimtarinë më të madhe inovative në vitet e fundit, ndjekur nga teknologjia e energjisë diellore dhe ajo e prodhimit të energjisë nga burimet ujore. Edhe teknologjia e shpërndarjes së energjisë ka treguar shkallë të lartë inovacioni. Veprimtaria e inovacionit në këta sektorë përjetoi maja të larta në periudhën 2010-2015 dhe tani duket se ka hyrë në një fazë më pak shtytëse. Teknologjitë e reja janë përqendruar te përmirësimi i teknologjive ekzistuese në vend që të prezantohen teknologji përmbyse. Megjithatë, disa prej tyre paraqesin paradigma të reja përdorimi të cilat do të kërkojnë një ripërkufizim më të fortë të aftësive të kërkuara për t'i përdorur ato.

Këtu më poshtë janë paraqitur tetë fusha kryesore të veprimtarisë së inovacionit në sektorin e energjisë, duke i renditur nga niveli më i lartë deri në më të ulët për nga niveli i krijimtarisë.

Efiçenca e energjisë: ligji i ri për efiçencën e energjisë parashikon një sërë detyrimesh për uljen e konsumit të energjisë nga sektori publik dhe privat. Njëri nga rezultatet e pritshme është rritja e ndërgjegjësimit ndër qytetarët shqiptarë sa i takon përdorimit dhe kursimit të energjisë.

Energjia nga dielli: energjia nga dielli është në themel të strategjisë së diversifikimit të energjisë në vend. Ka mjaft projekte në shfrytëzim, në ndërtim e sipër ose në fazë tenderimi dhe Shqipëria nuk është larg arritjes së objektivit prej 490 MW kapacitet energjie nga dielli në vitin 2020. Në rast se të gjitha projektet e planifikuara diellore vihen në shfrytëzim, në 10 vjet ato do të prodhonin të njëjtën sasi energjie elektrike të cilën vendi aktualisht e importon.

Energjia nga era: ndonëse qeveria shqiptare synon të prodhojë 5% të energjisë elektrike nga fermat e erës deri në vitin 2030, prodhimi i energjisë nga era ende nuk ka nisur. Kapaciteti i instaluar për energjinë nga era ende është i ulët për shkak të mungesës së investimeve, pavarësisht faktit se qeveria e paraqet energjinë nga era dhe energjinë nga dielli si zgjidhje paralele për vendin.

Energjia nga uji: impiantet më të mëdha në Shqipëri prodhojnë energji nga uji. Për të inkurajuar diversifikimin, qeveria tani jep licenca vetëm për hidrocentrale më të fuqishme. Si rezultat, pavarësisht investimeve të ardhme në energjinë nga dielli dhe era, nënsektori i energjisë nga burimet ujore do të mbetet i rëndësishëm për vendin.

Energjia termike: energjia termike mund të përfaqësojë një burim tjetër të rëndësishëm për prodhimin e energjisë për shkak të strukturave që projekti TAP ka sjellë në vend. Disa burime parashikojnë se gazi mund të përbëjë 20% të konsumit total të energjisë deri në vitin 2030. Mundësitë e krijuara nga përdorimi i strukturave të TAP-it, mund ta kthejnë gazin në një nga përparësitë kryesore në vitet që vijnë.

Teknologjitë tërthorëse: për disa prej grupeve të lartpërmendura zbatohen disa teknologji me vlerë më të lartë. Në mjaft prej tyre përdoren gjerësisht teknologjitë elektrike. Teknologjitë mekanike mbështetin projektimin dhe prodhimin e inovacionit në sektorin e energjisë në mënyrë të tërthortë. Inovacioni në fushën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) është një teknologji tjetër kryesore tërthorëse.

Transmetimi dhe shpërndarja: humbjet e energjisë përgjatë zinxhirit të transmetimit dhe shpërndarjes në Shqipëri vlerësohen të jenë rreth 25% dhe përmirësimi i efikasitetit energjetik është objektiv kryesor strategjik kombëtar. Shoqëritë e përfshira në këtë sektor po investohen fuqishëm në struktura interkonjeksioni dhe rrjeti në zonën bregdetare po zgjerohet dhe përmirësohet.

Transporti i naftës dhe gazit: strukturat e TAP-it sjellin një mundësi për shpërndarjen e gazit brenda Shqipërisë dhe përfaqësojnë gjithashtu teknologji të reja që kanë nevojë të mirëmbahen dhe riparohen. Kështu, gazsjellësi duhet të konsiderohet teknologji e lidhur me energjinë, për të cilën vendi duhet të zhvillojë aftësitë e nevojshme.

4. Ndryshimi i kërkesave për vendet e punës dhe kualifikimet në sektorin e energjisë

Kërkimet kanë nxjerrë në pah një kërkesë më të lartë për tre grupe pozicionesh pune si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur në teknologjinë dhe në politikat e sektorit të energjisë: vendet e punës me natyrë teknike ose teknologjike, shërbimet e biznesit dhe vendet e punës që lidhen me to si dhe pozicionet për ekspertë të reformës në sektorin e energjisë.

Për të identifikuar vendet më të rëndësishme të punës për të ardhmen e energjisë në Shqipëri, u kombinuan teknikat e përparuara të shfrytëzimit të të dhënave me kërkimet në dokumentacion dhe me anketimet. Kjo qasje parashikon kërkesë të lartë për inxhinierë të energjisë, për inxhinierë mekanikë, inxhinierë ndërtimi, inxhinierë elektrikë dhe për të gjitha pozicionet tërthorëse në kategorinë e parë të vendeve të punës me profil teknik. Do të ketë nevojë gjithashtu për operatorë të hidrocentraleve dhe për operatorë të impianteve të prodhimit të energjisë diellore dhe – në përgjithësi – për një përzierje profilesh më të specializuara në tri industritë kryesore të energjisë së përtëritshme të vendit: ujë, diell dhe erë.

Një kategori e dytë profilesh përmbledh vendet e punës të lidhura me biznesin të cilat janë të rëndësishme për modelet e biznesit të përqafuluara nga shoqëritë tregtare dhe për mënyrën se si ato organizojnë prodhimin, marketingun dhe shitjet. Këto vende pune mund të ndahen në dy grupe të veçanta. Grupi i parë përfshin profesionistët e biznesit dhe të administratës që lidhen me aspektet operacionale të impianteve: menaxherët e prodhimit, menaxherët e energjisë, menaxherët operacionalë dhe menaxherët e impianteve të prodhimit të energjisë. Grupi i dytë përfshin profesionet e konsulentit dhe përfaqësuesit që lidhen me tregun: konsulentët e energjive të rinovueshme, konsulentët e energjisë nga dielli dhe përfaqësuesit e shitjeve të energjisë elektrike.

Përveç kësaj, transformimi i sektorit të energjisë në Shqipëri po orienton kërkesën për profile ekspertësh të cilët ndihmojnë menaxhimin e tranzicionit drejt paradigmave të reja: këto profile nuk janë gjetur në Shqipëri deri tani. Në profilin e rëndësishëm eksperti është menaxheri i energjisë, i cili mban nën monitorim konsumin e energjisë, dikton humbjen e energjisë dhe sugjeron masat dhe strategjitë për përdorimin më eficient të energjisë. Gjithashtu, kërkesa për profilin e vlerësuesit të energjisë dhe të audituesit të energjisë është në rritje. Kërkesa e lartë për ekspertizë dhe konsulentë në fushën e energjisë të cilët të kontribuojnë në vendimarrjen strategjike, në përhapjen e teknologjive të reja dhe në investimet në energjitë e përtëritshme përbën një sfidë për kualifikime komplekse në Shqipëri, duke i orientuar mjaft shoqëri tregtare drejt kontraktimit të ekspertizës së huaj. Një shembull tjetër i ekspertizës me ndikim të hidrocentralet dhe të impiantet e energjisë nga dielli dhe nga era është monitorimi dhe parashikimi i motit.

Profilat me kualifikime në fusha të ndryshme – duke përfshirë mjaft profile të tjera inxhinierike – janë shumë të rëndësishme në sektorin e energjisë. Përveç kësaj, rritja e pritshme e burimeve të përtëritshme do të krijojë profesione të reja me kualifikime specifike. Ndërkohë, hyrja e teknologjive digjitale në sektorin e energjisë do të kërkojë profile me natyrë teknike dhe biznesi dhe të pasurit e kualifikimeve tërthorëse në fushën e teknologjisë së informacionit. Punëtori i së ardhmes duhet të ketë një sërë kualifikimesh më të gjera dhe teknologjitë digjitale do të jenë pjesa thelbësore e kualifikimeve të kërkuara. Si rezultat i rritjes së përdorimit të automatizimit, po lindin edhe profile të reja profesionale.

Sa i takon punëtorëve me kualifikim të mesëm dhe punëtorëve të pakualifikuar, rolet e teknikëve të mesëm/ulët do të kërkojnë vazhdimisht në këtë sektor. Pritet që për profesionet shumë të kualifikuara dhe mesatarisht të kualifikuara kërkesa të jetë shumë e lartë në të ardhmen dhe strategjitë e aftësimit dhe riaftësimit profesional do t'u bëjnë të mundur punëtorëve të pakualifikuar të përditësohen për hyrjen e teknologjive më të reja. Soft skills (aftësitë e buta) – si vendosmëria, disiplina dhe vullneti për të mësuar – do të bëhen edhe më të rëndësishme në të ardhmen.

5. Nismat e sektorit për të plotësuar nevojat e ndryshueshme për kualifikime

Ndërkohë që sektori tradicional i energjisë në Shqipëri mbizotërohet nga shoqëritë në pronësi të shtetit, pjesa më e madhe e shoqërive në fushën e energjisë së përtëritshme janë të vogla dhe në pronësi private. Ky fakt ushtron ndikim negativ të përdorimi i teknologjisë dhe të nismat e zhvillimit të aftësive në këtë sektor. Politika e diversifikimit të energjisë nuk po ecën me shpejtësinë që kishte planifikuar fillimisht qeveria. Te faktorët kufizues përfshihen: ndikimi mjedisor i investimit në energji të përtëritshme, skepticizmi për kostot dhe përfitimet nga burimet e reja të energjisë, mungesa e kualifikimeve (sidomos në nivelin e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP)) dhe mungesa e investimit në infrastrukturën ekzistuese.

Padyshim, mungesa e punëtorëve me përvojën dhe kualifikimet e nevojshme po e kufizon rritjen në sektorin e energjisë. Mungesa e personave me përvojë është faktor kyç që pengon nënsektorët si ai i energjisë nga dielli të zgjerohen më tej. Hendeku i kualifikimeve lidhet edhe me daljen në pension të punëtorëve të kualifikuar. Shoqëritë e kanë të vështirë të gjejnë punëtorë të rinj të kualifikuar për t'i zëvendësuar ata. Shpesh mungon transferimi i njohurive dhe i aftësive nga shoqëritë e huaja të vendasit sepse punëtorët shqiptarë përjashtohen nga detyrat me kualifikim të lartë ose në fushën e teknologjisë. Raportohet edhe mospërputhje midis kurikulës arsimore dhe nevojave për kualifikime në botën reale.

Kjo mospërputhje i ka detyruar shoqëritë të organizojnë trajnime të tjera për punëtorët e saporekrutuar, riaftësimin e punëtorëve ekzistues dhe kontraktimin nga jashtë. Trajnimi i brendshëm është strategjia më e zakonshme e përdorur nga shoqëritë për t'u përballur me mungesën e përvojës dhe të kualifikimeve në këtë sektor. Qeveria po përpaket të nxitë lidhjen më të ngushtë midis sektorit publik dhe atij privat dhe mjaft shoqëri po punojnë në partneritet me universitetet në fushën e trajnimeve. Automatizimi dhe digjitalizimi shihen si motorët shtytës të ndryshimit të ardhshëm në sektor.

Si rekomandim, ekziston nevoja për të rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm për të mirat e teknologjive të përtëritshme dhe për vlerën e tyre të shtuar për biznesin. Duhet të forcohet bashkëpunimi dhe komunikimi midis të gjithë aktorëve pjesëmarrës dhe partneriteteve publike-private, për të garantuar shkëmbimin e informacionit të përditësuar rreth evolucionit të sektorit të energjive të përtëritshme. Ka munguar qasja sistematike kundrejt kualifikimeve sipas nevojave të bizneseve: një qasje më sistematike për analizën e nevojave për kualifikime do të ndihmonte përkthimin e informacionit në veprime konkrete.

Qeveria po punon të rritë bashkëpunimin midis sektorit arsimor dhe biznesit, ndërsa një zhvillim i ri në politika synon përmirësimin e aftësive digjitale të krahut të punës. Edhe kontraktorët e huaj mund të ndihmojnë me anë të transferimit të aftësive dhe programeve të zhvillimit për krahun vendas të punës.

Për ta mbyllur, Shqipëria ka nevojë për një agjendë politike afatgjatë, me një vizion të qartë për të përshpejtuar tranzicionin energjetik dhe për planifikimin e aktiviteteve për një periudhë 10-20 vjeçare sa i takon investimeve, projekteve të ardhshme të zhvillimit, punësimit dhe kualifikimeve. Nevojiten përpjekje të veçanta për të forcuar lidhjet midis investitorëve/shoqërive tregtare dhe ofruesve të arsimit dhe formimit. Vetë biznesi duhet të krijojë më shumë mundësi për të mësuar gjatë punës. Shoqëritë e huaja duhet të përfshijnë trajnimin e punëtorëve vendas si pjesë e paketave të investimit. Dhe ofruesit shqiptarë të trajnimeve duhet bashkëpunojnë në mënyrë më aktive me homologët evropianë, të cilët kanë zhvilluar kurikula dhe programe të përshtatura për sektorin e energjisë.

Ku të zbuloni më tepër

Website	www.etf.europa.eu
ETF Open Space	https://openspace.etf.europa.eu
Twitter	@etfeuropa
Facebook	facebook.com/etfeuropa
YouTube	www.youtube.com/user/etfeuropa
Instagram	instagram.com/etfeuropa/
LinkedIn	linkedin.com/company/european-training-foundation
Email	info@etf.europa.eu

